



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0618

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE Bazalti-S Sh.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontrate ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Urave në Komunën e Rahovecit” me numër të prokurimit: "623-24-5118-5-2-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal - Rahovecë, më 30.08.2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa me nr. 2024/0618 e datës 11.07.2024 e Operatorit Ekonomik (OE) Bazalti-S Sh.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontrate ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Urave në Komunën e Rahovecit” me numër të prokurimit: "623-24-5118-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal - Rahovec.
2. Anulohet, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58), për dhënie të një kontrate ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit të datës 27.06.2024, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
3. Kërkohet që AK në afat prej 10 ditësh ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i precizuar si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të LPP.
4. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, kurse Ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve sipas nenit 31 paragrafi 6, të Rregullores për Punën e OSHP, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 24.05.2024 Kuvendi Komunal - Rahovecë., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Urave në Komunën e Rahovecit” me numër të prokurimit: "623-24-5118-5-2-1". Me 27.06.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin (B58) e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik: Gzimi- Garten-UND Landschaftsbau Sh.P.K; AGE group Sh.P.K. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë me vlerë të parashikuar të kontratës 188,349.79 euro.

Me 02.07.2024 OE Bazalti-S Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Më 02.07.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.07.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Bazalti-S Sh.P.K., me numër protokolli 2024/0618 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Urave në Komunën e Rahovecit” me numër të prokurimit: "623-24-5118-5-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara nga neni 111 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe si e tillë është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109, paragrafi 1 i LPP-së, pas përfundimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 26 i LPP-së. Në këtë kontekst, Paneli Shqyrtues ka verifikuar se ka kompetencë për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP-së dhe nuk ekzistojnë pengesa procedurale për të vazhduar me shqyrtimin meritorë të ankesës.

Pretendimet e paraqitura nga Operatori Ekonomik (OE) ankues : "Kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga Operatorin Ekonomik Bazalti-S SH.P.K. specifikon se OE i rekomanduar për kontratë ka shkëlur disa kërkesa të dosjes së tenderit në aspekte të ndryshme. Së pari, Menaxheri i Projektit, z. Bushra Hasani, nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për përvojën e kërkuar prej 6 vitesh pas diplomimit, duke munguar disa dokumente të nevojshme, përfshirë dëshminë nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Po ashtu, Udhëheqësi i Punishtes, z. Sami Hoxha, nuk ka plotësuar kërkesat për dëshmi nga ATK dhe kontrata e tij e punës nuk mbulon periudhën e kërkuar. Inxhinieri Elektroteknik, z. Valon Jahaj, gjithashtu ka dështuar të ofrojë dëshmi të nevojshme nga ATK dhe afati i kontratës së tij nuk përputhet me periudhën e kërkuar. Specialisti në Menaxhimin e Emergjencave, z. Gazmend Begaj, ka dështuar në ofrimin e dëshmive të nevojshme nga ATK dhe kontrata e tij nuk mbulon periudhën e kërkuar për implementimin e projektit. Përveç këtyre, Bazalti-S SH.P.K. pretendon se OE i rekomanduar nuk i ka përmblusur kërkesat për kontratat e realizuara dhe standardet ISO. Sipas tyre, kontratat e prezantuara nuk janë të ngjashme me aktivitetet e prokurimit dhe certifikatat ISO të ofruara nuk janë në përputhje me kërkesat e tenderit. Dokumentacioni për pajisjet dhe sigurimin e tenderit gjithashtu nuk është në përputhje me kërkesat, duke përfshirë marrëveshjet e përdorimit të pajisjeve dhe specifikimet e kërkuara në tender. Për këto arsye, kërkohet që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë vendimin

dhe të konsiderojë refuzimin e OE-së për të siguruar përputhshmërinë me ligjin dhe kërkesat e tenderit. Duke u referuar kërkesave të lartpërmendura, Bazalti-S SH.P.K. argumenton se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 1, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 40 të Rregullores për Prokurim Publik 001/2022. OE Bazalti-S SH.P.K. kërkon që njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të anulohet dhe lënda të kthehet për rishqyrtim, duke siguruar që gjatë procesit të rishqyrtimit të bëhet një ekzaminim, vlerësim dhe krahasim i ofertave në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik."

Përgjigjet nga Autoriteti Kontraktues (AK) -" Ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik "BAZALTI-S SH.P.K." të paraqitur më 2 korrik 2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit për "Ndërtimin e Urave në Komunën e Rahovecit". AK kishte publikuar vendimin e tij më 27 qershor 2024, përmes ueb-faqes zyrtare të e-prokurimit, duke rekomanduar një operator tjetër ekonomik për kontratë. Pretendimet ankimore të BAZALTI-S SH.P.K. janë shqyrtuar nga AK, i cili i konsideroi të pabazuara. AK argumentoi se tenderi i operatorit të rekomanduar për kontratë ishte në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e njoftimit të kontratës dhe dosjes së tenderit, duke përfshirë emërimin e menaxherit të projektit, udhëheqësit të punishtes dhe dokumentet e tjera teknike dhe profesionale. Sipas AK-së, kontratat e punës së prezantuara nga operatori i rekomanduar, si dhe përvoja dhe certifikatat e personelit të angazhuar, ishin në përputhje me kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, AK konstatoi se sigurimi i tenderit ishte i saktë dhe përputhej me aktivitetin përkatës të prokurimit. Në përfundim, AK vendosi që pretendimet e BAZALTI-S SH.P.K. nuk ishin të bazuara dhe mbajti në fuqi vendimin e mëparshëm."

Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur në nenin 111, paragrafi 5, lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP-së, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 17.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0618. Më 25.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0618, ku rekomandohet që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës është pranuar nga të gjitha palët procedurale. Megjithatë, AK dhe OE nuk janë pajtuar me rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 24, paragrafi 1 të Rregullores së Punës së Organeve Shqyrtuese të Prokurimit (OSHP). Duke marrë parasysh pretendimet e palëve, provat e paraqitura dhe raportin e ekspertit shqyrtues, paneli ka vendosur që ka të dhëna të mjaftueshme për të bërë një vendim meritorë lidhur me rastin.

Për të realizuar një shqyrtim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar një mori provash që përfshijnë:

- Raportin e ekspertit shqyrtues, i cili përmban analizën dhe rekomandimet e ekspertit mbi pretendimet e paraqitura nga palët.
- Mendimet dhe komentet e palëve në lidhje me raportin e ekspertit, të cilat ofrojnë perspektiva të ndryshme mbi çështjet e diskutueshme.
- Parashtrësas dhe dokumentet e paraqitura nga ankuesi, që ndihmojnë në sqarimin e pretendimeve dhe argumenteve të ngritura.
- Shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, të cilat dokumentojnë procesin dhe vendimet e marra në lidhje me aktivitetin e prokurimit.
- Dokumentet relevante që lidhen me aktivitetin e prokurimit, siç janë dosjet e tenderëve dhe raportet e vlerësimit.
- Të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale, duke përfshirë dokumentet shtesë dhe dëshmitë që ndihmojnë në verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e tenderit dhe ligjin.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet (I,II,III dhe IV) të parashtruara nga OE ankues konstaton: " Këto pretendime lidhen me dokumentacionin e paraqitur nga Menaxheri i Projektit, z. Bushra Hashani, dhe Udhëheqësi i Punishtes, z. Sami Hoxha, i cili ka konfirmuar se dokumentet e dorëzuara nga këta individë janë të pranueshme, edhe pse kontratat përkohshme të paraqitura nuk përmbushin plotësisht kërkesën për një periudhë të plotë prej 24 muajsh. Për Inxhinierët e tjerë, përfshirë Inxhinierin Elektroteknik, Inxhinierin Hidroteknik dhe Inxhinierin Urbanist, është verifikuar se dokumentacioni i dorëzuar është në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Dëshmitë për stafin janë konfirmuar si të pranueshme dhe nuk kërkohet përputhshmëri e plotë e periudhës së kontratës për menaxherin e projektit dhe udhëheqësin e punishtes për të plotësuar kërkesat e tenderit."

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor (V) të parashtruar nga OE ankues konstaton : " Ky pretendim lidhet me vlerën e referencave të dorëzuara nga OE "Bazalti-S" sh.p.k., e cila është afërsisht 178,000 €, ndonëse kërkesa minimale është 282,500 €. Eksperti ka vlerësuar se është e mundur të kërkohen informacionet sqaruese të nevojshme për të përmbushur këtë kërkesë, në përputhje me UDHËZUES Nr. 001/2023. Ky pretendim është konsideruar i bazuar dhe mund të kërkohen informacionet shtesë për të përmbushur kërkesat e tenderit."

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor VI konstaton se i njejtë lidhet me çertifikatat ISO të dorëzuara nga OE "Bazalti-S" sh.p.k. Eksperti ka verifikuar se çertifikatat e paraqitura janë të vlefshme dhe përmbushin kërkesat e Autoritetit Kontraktues për ISO 9001-2015, ISO 45001-2018, dhe ISO 14001-2015. Ky pretendim është konsideruar i pabazuar, pasi çertifikatat janë në përputhje të plotë me kërkesat e AK.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor VII konstaton se i njejtë lidhet me dokumentacionin për pajisjet dhe mekanizimin e ofruar nga OE "Bazalti-S" sh.p.k. Eksperti ka analizuar dokumentet dhe dëshmitë për pajisjet e paraqitura dhe ka konfirmuar se ato janë të

pranueshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues. Megjithatë, është thelbësore që çdo pajisje të ketë dokumentacionin e nevojshëm përkatës. Ky pretendim është konsideruar i pabazuar, pasi dokumentet për pajisjet janë të pranueshme dhe në përputhje me kërkesat e AK.

Paneli Shqyrtues ka administruar dhe vlerësuar të gjitha provat dhe pretendimet e paraqitura, duke përfshirë raportin e ekspertit, dokumentet dhe mendimet e palëve, dhe ka arritur në përfundimin se disa pretendime janë të bazuara dhe kërkojnë informacion të mëtejshëm, ndërsa të tjerat janë të pabazuara dhe përmbushin kërkesat e dokumentacionit të tenderit. Ky proces ka ndihmuar në sigurimin e një shqyrtimi të drejtë dhe të plotë të çështjes, duke kontribuar në marrjen e një vendimi të drejtë dhe të informuar.

Gjetjet e Panelit Shqyrtues

Paneli Shqyrtues, në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje të lartë dhe kujdes profesional, ka realizuar një vlerësim të detajuar të të gjitha provave të dorëzuara në rastin në fjalë. Pas shqyrtimit të plotë, është arritur në përfundimin se Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Urave në Komunën e Rahovecit”, me numër të prokurimit: "623-24-5118-5-2-1".

Paneli Shqyrtues ka administruar të gjitha dokumentet e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK-së, parashtrirat dhe provat e paraqitura nga ankuesi, si dhe raportin e ekspertit shqyrtues. Duke analizuar të gjitha këto elemente në kontekstin e përgjithshëm të çështjes, Paneli ka arritur në një bindje të pavarur dhe të justifikuar se ankesa e Operatorit Ekonomik (OE) ankues është e bazuar. Paneli vëren se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban të gjitha pohimet dhe analizat lidhur me ankesën, duke i shpjeguar në mënyrë të detajuar shkeljet e identifikuar në përputhje me dispozitat e nenit 113 dhe 114 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Në këtë kontekst, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Paneli urdhëron anulimin e njoftimit mbi vendimin e AK-së dhe kthen lëndën për ri-vlerësim.

Në përputhje me vlerësimin e pavarur të tij në kuptim të nenit 105, dhe duke marrë parasysh kërkesat e nenit 104, paragrafi 1 të LPP-së, sipas të cilit: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, me qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës,” si dhe në harmoni me nenin 1 të LPP-së, i cili synon të sigurojë integritetin dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë të përfshirë në aktivitetin e prokurimit, Paneli Shqyrtues ka mbështetur konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së që rregullojnë situata të tilla.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe argumenteve të paraqitura, ka përfunduar se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së. Në këtë kuadër, Paneli urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në përputhje me kompetencat e cituara dhe nenin 104, paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të LPP-së, si dhe duke iu referuar nenit 117 të LPP-së dhe provave të prezantuara, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë Padi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit në Gjykatën Komerciale/Departamentit për çështje Administrative në Prishtinë.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - " BAZALTI-S " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: